Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0714

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "MOVIOLA" L.L.C., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi" me numër të prokurimit 210-23-7815-2-2-1, me 12/12/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa e OE " MOVIOLA " L.L.C. me nr. 2023/0714, e datës 21/09/2023, kurse vendimi i AK Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor lidhur me aktivitetin e prokurimit "Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi" me numër të prokurimit 210-23-7815-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " MOVIOLA " L.L.C.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 27.07.2023, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi" me numër të prokurimit 210-23-7815-2-2-1. Ndërsa me datën 04.09.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin ka shperblyer me kontratë Tatamata Bashkim Fehmiu 39, Prishtinë 600275053, me çmimin e ofertës në vlerë prej 85,940.00 €.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës sherbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 90,000.00 €.

Me 08.09.2023, OE " MOVIOLA " L.L.C ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 11.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 21.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " MOVIOLA " L.L.C me nr. 714/23 lidhur me aktivitetin "Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi" me numër të prokurimit 210-23-7815-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Pretendimet e operatorit ekonomik ankuesOE " MOVIOLA " L.L.C janë parashtruar si në vijim**:**

Ankuesi pretendon se *"Ne si OE kemi dorëzuar ofertën pranë Autoritetit Kontraktues duke plotësuar kriterin bazë të procedurës, oferta e përgjegjshme me çmimin me te lirë, duke ofruar ofertën në vlerë prej: 67,968.00 €, ndërsa çmimi i ofertës të OE, të shpallur fitues është: 85,940.00 €, me një ndryshim më të lartë se sa oferta jonë në vlerë prej: 17,972.00 € . AK per arsyjet e refuzimit te kerkeses per rishqyrtim deklaron se cmimi i ofertes fituese eshte brenda vleres se parashikuar te kontrates duke mos marre për bazë se oferta jonë eshte me e lirë."*

Me tutje ankuesi pretendon se "*Lidhur me kërkesën për certifikatën e biznesit ne e kemi dorëzuar sqarimin sipas kërkesës të AK, me datë: 24.08.2023. Përkundër ofrimit të sqarimeve, AK nuk i ka marrë për bazë dhe si arsyetim të eleminimit ka ofruar një 'screenshot' nga web faqja e ARBK-së ku biznesi jonë figuronte si "pasiv" gjë e cila është e pakuptueshme sepse ne kemi marr dokumenta nga ARBK të lëshuara me datë 24.08.2023 dhe në asnjë moment nuk na është tërhequr vëmendja se biznesi jonë figuron si pasiv.(Dëshmi: Konfirmimin për këtë, nga*

ARBK e gjeni të bashkangjitur me Ankesë. " i dhe nkuesi pretendon se "si *Operator ekonomik konkurrues të përgjegjshëm me çmimin më të ulët e kemi ofruar/plotësuar deklaratën nën betim sipas nenit 6.4. të përcaktuar dhe kërkesës së dosjes së tenderit sipas aneksit 2 (Dëshmi*: *deklaratën nën betim të dorëzuar me ofertë dhe interpretimin nga KRPP)."*

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "MOVIOLA" L.L.C konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 4.4.1, 4.3, 45.17 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

AK ne vendimin e kërkesës për rishqyrtime te datës kishte eliminuar ankuesin me pretendimin Ankuesi nuk kishte prezantuar certifikatën e biznesit sipas kërkesave te AK, ka ofertuar me biznes pasiv sipas webfaqes se ARBK-se.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22/09/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 714/23, ndërsa me datë 30/09/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0714 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "MOVIOLA " L.L.Ceksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0714 ka vlerësuar si në vijim: "*Pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaroj se, OE ankuesi në ofertë ka të bashkangjitur deklaratën nën betim të cilën deklaratë ka ndërhyrje pasi e ka shkarkuar nga e-prokurimi, deklarata nën betim nuk posedon tutillin e aktivitetit të prokurimit, numrin e prokurimit, por ka të vendosur logon e biznesit, përkundër që AK ka specifikuar edhe në njoftimin për kontratë lidhur me kërkesën. Mirëpo meqenëse deklarata është e bashkangjitur, si dhe marrë parasyshë qëllimin e aktivitetit të prokuirmit sipas nenit 1, 6, 7 të LPP-së, ku i njëjti është më i lirë se sa OE i rekomanduar për rreth 17 mijë e 900 euro, atëherë mendoj se AK këtë devijim mund ta konsideron si devijim i vogël konform nenit 59.4 të LPP-së. Andaj si i tillë pretendimi i OE ankues gjendet* ***pjesërisht i bazuar.***

AK ka eliminuar OE ankuesin me arsyen se Biznesi nuk është aktiv, mirëpo përkundër fakteve të paraqitura nga OE ankues në ankesë, fillimisht kam kërkuar ne webfaqe të ARBK lidhur me biznesin, i cili del se është i regjistruar, po ashtu kam kërkuar sqarime pranë ARBK, ku këta të fundit na sqarojnë se biznesi është i regjistruar, kurse sa i përket statusit Aktiv rekomanduan që të drejtohemi në ATK, mirëpo meqenëse OE ankuesi po ashtu posedon vërtetimin tatimor ne oferte, atëherë përmes numrit serik kam kërkuar ne webfaqe te ATK-se lidhur vërtetimin tatimor, dhe si e tille vërtetohet qe ky dokument është valid dhe se OE ankuesi posedon biznesin aktiv, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet ***i bazuar."***

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues"OE " MOVIOLA " L.L.C. Argumentimi në raportin e ekspertes është i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertes mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE " MOVIOLA " L.L.Cjanë pjesërishtë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertes shqyrtuese, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet pjesërisht si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor të datës 04.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Angazhimi i nje OE per PR-Public Relation për MMPHi" me numër të prokurimit 210-23-7815-2-2-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

AK ne kërkesën per rishqyrtim e kishte eliminuar ankuesin me pretendimin Ankuesi nuk kishte prezantuar certifikatën e biznesit sipas kërkesave te AK, por kishte aplikuar me biznes pasiv. Nga ana tjetër ankuesi ka pohuar se AK kishte kërkuar sqarime na te njetit ,kurse përkundër ofrimit të sqarimeve me datë 24.08.2023, AK nuk i kishte marrë për bazë duke ofruar si arsyetim të eleminimit një 'screenshot' nga web faqja e ARBK-së ku biznesi jonë figuronte si "pasiv" gjë e cila është e pakuptueshme per ne si OE sepse ne kemi marr dokumente nga ARBK të lëshuara pikërisht me datë 24.08.2023 dhe në asnjë moment nuk na është tërhequr vëmendja se biznesi jonë është apo figuron si pasiv duke ofruar në cilësi të provës për panelin Konfirmimin nga ARBK, po ashtu" Si dhe se "si Operator ekonomik konkurrues të përgjegjshëm me çmimin më të ulët ne kemi ofruar/plotësuar deklaratën nën betim sipas nenit 6.4. të përcaktuar dhe kërkesës së dosjes së tenderit sipas aneksit kurse si dëshmi ka prezantuar deklaratën nën betim të dorëzuar me ofertë dhe interpretimin nga KRPP

Eksperti shqyrtues lidhur me këtë ka sqaruar se ne webfaqe të ARBK ky biznes figuron se është i regjistruar, megjithatë e njëjta i është drejtuar serish në ARBK për sqarime kurse me 11.12.2023, ka pranuar përgjigje se ky biznesi është i regjistruar në ARBK, ndërsa sa i përket "statusit Aktiv apo Pasiv i biznesit" ARBK rekomandon se lidhur me këtë duhet të drejtohen në ATK për sigurimin e këtij informacioni. Nga ana tjetër Eksperti Shqyrtues lidhur me këtë sqaron se Ankuesi posedon vërtetimin tatimor ne oferte, kurse ky vërtetim ishte verifikuar pranë webfaqes së ATK sipas numrit serik dhe ka rezultuar se dokument është valid dhe se OE ankuesi posedon biznesin aktiv. Kurse sa i përket pretendimit tjetër se deklarata nën betim ka ndërhyrje dhe nuk përmban titullin e aktivitetit të prokurimit dhe numrin e prokurimit, por ne vend të tyre ka të vendosur logon e biznesit, nga ana tjetër AK ka specifikuar në Aneksin 2 te dya elementet titullin dhe numrin e aktivitetit të prokurimit, eksperti ka pohuar se deklarata është e bashkangjitur ne ofertën e ankuesit edhe pse nuk përmban këto elemente nënkupton se bëhet fjalë për këtë aktivitet andaj duke marrë parasysh qëllimin e aktivitetit të prokurimit sipas nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-së, ku ankuesi është më i lirë se sa OE i rekomanduar për rreth 17 mijë e 900 euro, atëherë AK këtë devijim mund ta konsideron si devijim të vogël konform nenit 59.4 të LPP-së.

Paneli shqyrtues mbi bazën e të lartëcekurave kërkon nga AK gjatë procesit të rivlerësimit nëse provat e prezantuara nga eksperti dhe ankuesi nuk janë të mjaftueshme për komisionit e rivlerësimit, të njëjtit mund të kërkojnë sqarime te detajuara që nga data e inicimit të këtij aktiviteti e deri më tani lidhur me statusin e biznesit të ankuesit pranë institucioneve relevante siç janë ATK dhe ARBK, kurse sa i përket deklaratës paneli niset gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore mirëpo AK duhet të kujdeset ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së kurse mungesa elementeve sa i përket titullit dhe numrit te aktivitetit në deklaratën nën betim edhe pse i njëjti këtë deklaratë e kishte prezantuar brenda ofertës së tij/saj vlerëson në këtë rast se përgjegjësia për ta konsideruar si "devijim i vogël" konform nenit 59.4 i takon direkt AK në vështrim të neneve 1.6, 7, 8 dhe 9 të LPP-së.

Andaj paneli shqyrtues në vështrim të dispozitave të nenit 1 dhe 6 të LPP, ka vlerësuar se në këtë rast duhet të obligohet AK të aplikojë nenin 52 dhe 72 sa i përket certifikatën e regjistrimit të biznesit gjatë rivlerësimit.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së

shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin 1 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
- OE - **" MOVIOLA " L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: